



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 80 Akti

Nr. 101 Vendimi

Tiranë, më 23.01.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)

Pamela Qirko

Xhensila Pine

Kryesues

Anëtare

Relatore

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, më datë 21 janar 2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Altin Binaj, prokuror dhe drejtues pranë Prokurorisë së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Xhensila Pine, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tri kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ushtron detyrën e prokurorit dhe drejtuesit pranë Prokurorisë së Apelit Vlorë dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 24.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

6. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport, për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Binaj.*

8. Prokuroria e Përgjithshme, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

9. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 06.12.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 07.12.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij më datë 17.12.2018.

12. Trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin e caktuar për paraqitjen e provave dhe parashtrimeve, afat, nga data 17.12.2018, në datën 31.12.2018, për arsye të kohës shtesë të kërkuar nga subjekti për të paraqitur prova të reja.

13. Pas administrimit e shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 18.01.2019.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 21.01.2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

16. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në Aneksin e Kushtetutës, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- b) Deklaratat vjetore të pasurisë si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- d) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) Shpjegimet me shkrim dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

20. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Binaj, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklaram të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, rezulton si vijon:

21. Apartament banimi, me sip. 102.2 m², ZK ***, nr. pasurisë ***, vol. ***, fq. ***, ndodhur në lagjen “****”, Vlorë. Çmimi i blerjes në vlerën 3.500 000 lekë. Burimi i deklaruar: Blerë në vitin 2005, nga shitja e banesës së mëparshme të përfituar nga privatizimi i ish-banesave shtetërore, në pronësi të deklaruesit dhe nënës së tij.

22. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

23. ZVRPP-ja Vlorë me shkresën, nr. *** prot., datë 28.02.2018, informon se në emër të shtetasve: Altin M. Binaj, N. A. B, rezulton pasuri në bashkëpronësi në ZK ***, nr. pasurisë ***, vol. ***, fq. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 102.22 m².

24. Nga informacioni i OSSHE-së për abonentin, rezulton se kontrata ***, ka datë hapje 31.01.2006, kabina ***.

Nga hetimi administrative i kryer përputhen deklaramet e subjektit me faktet e dala nga hetimi administrativ.

25. Apartament banimi, me sip 56.2 m², ZK ***, nr. i pasurisë ***, vol. ***, fq. ***, ndodhur në njësinë administrative, ***, Bashkia Vlorë, lagjja: “****”. Çmimi i blerjes në vlerën 15.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. Burimi: Blerë në vitin 2013, nga të ardhurat familjare ndër vite.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

26. ZVRPP-ja Vlorë me shkresën, nr. *** prot., datë 28.02.2018, informon se në emër të znj. N. B, rezulton pasuri në ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, lloji i pasurisë ndërtesë me sip. 56 m².

27. Nga kartela e pasurisë sipërfaqja totale e pasurisë është 56 m². Data e regjistrimit të pasurisë është data 16.09.2013. Në këtë kartelë ka një përshkrim të veçantë “Shtesë 1 kat në objekt banimi 6-katësh. Sipërfaqe e katit bazë = 56 m². Sipërfaqe e katit shtesë = 56 m²”.

28. Kjo pasuri është regjistruar me lejen e legalizimit nr. ***, datë 16.09.2013, për shtesë një kat në lartësi, në emër të znj. N. B, ndodhur në ***. Numri i kateve mbi tokë 6 +1 kat shtesë.

29. ZVRPP-ja Vlorë, me shkresat kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 09.03.2018 dhe nr. *** prot., datë 09.03.2018, informon Komisionin në lidhje me çmimet e referencës për vitin 2013.

30. ALUIZNI Vlorë, me shkresën, nr. *** prot, datë 12.06.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit praktikën e legalizimit të objektit informal aplikuar nga znj. N. A. B.

31. Sipas aktmarrëveshjes “Për dorëzimin e apartamentit”, midis z. A. B në cilësinë e sipërmarrësit dhe znj. N. B, më datë 05.03.2013, në ***: *“Apartamenti nr. *** në katin shtesë me sipërfaqe totale 69.24 m², nga të cilat sipërfaqe banimi 53.63 m² dhe sipërfaqe të përbashkëta 15.61 m², i dorëzohet shtetases N. B në gjendjen që ekziston, duke i kaluar çdo të drejtë ligjore lidhur me disponimin dhe gëzimin e këtij sendi”.*

32. Sipas kërkesës nr. *** prot., datë 25.06.2013, znj. N. B, ka kërkuar legalizimin për shtesë pallati në ***, Vlorë, me sipërfaqe ndërtimi 53.63 m², me funksion apartament banimi.

33. Pyetur për këtë pronë subjekti vuri në dispozicion të Komisionit¹ shkresën kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 24.10.2018, nga ZVRPP-ja Vlorë e cila konfirmon se pasuria me nr. ***, vol. ***, fq. *** e llojit ndërtesë me sip. 56 m², ZK ***, ***, është regjistruar në kartelë në seksionin C të pronësisë në emër të znj. N. B. Shënimi veçantë në kartelën e pasurisë kati bazë me sip. 56 m² dhe kati shtesë me sip. 56 m².

34. Ju kalua barra e provës, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova për sa referuar dokumentacionit të marrë nga ZVRPP-ja Vlorë, pasi referuar shënimit të veçantë në kartelën e pasurisë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij duket se kanë apartament *dupleks* në këtë ndërtesë, si dhe për të shpjeguar mënyrën e pagesës për këtë pasuri.

35. Në përgjigje të barrës së provës subjekti deklaroi, se jo vetëm që apartamenti në fjalë nuk është *dupleks*, por as asnjë pjesëtar tjetër i familjes sime nuk ka pasur ndonjëherë në pronësi, apo në posedim, dhe as ka banuar ndonjëherë në apartament të tillë.

36. Në përgjigje të barrës së provës subjekti deklaroi se: *“Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit justifikues për likuidimin e apartamentit në ***, e duke qenë një veprim juridik privat, më datë 05.03.2013, likuidimi ishte i lejuar nga legjislacioni civil, në fuqi në atë datë sepse nuk ka pasur asnjë rregullim specifik për lëvizjet monetare midis individëve/personave fizikë, për aktet joformale jashtë zyrave noteriale dhe as ka pasur ndonjë kufizim tjetër ligjor për kryerjen e pagesave cash midis individëve jashtë atyre zyrave”.*

¹ Shih dokumentacionin bashkëlidhur pyetësorit të 2-të dërguar nga subjekti, më datë 26.10.2018, në dosjen e Komisionit.

37. Në përgjigje të barrës së provës subjekti deklaroi se: “*Akti joformal i dorëzimit të sendit, kryer midis dy individëve që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare, nuk mbart detyrimin ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar, pasi ky detyrim mund të vihet në diskutim për veprimet ndërmjet subjekteve tregtare dhe kjo për efekt të deklarimit të tatimit, ndërsa në rastin konkret pagesa cash e kryer në atë periudhë midis dy personave fizikë nuk ka pasur asnjë kufizim ligjor*”.

38. Në përgjigje të barrës së provës subjekti deklaroi se: Për këtë pasuri janë paguar të gjitha taksat që parashikojnë procedurat për legalizimin, bazuar në VKM-në nr. 1180, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimit të ardhurave të procesit të legalizimit” i cili shtrin efektet e tij nga data 1 mars 2008.

39. Në përgjigje të barrës së provës subjekti depozitoi gjithashtu shkresën kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 24.10.2018, të ZVRPP-së Vlorë.

40. Nga formulimi i shkresës kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 24.10.2018, të ZVRPP-së Vlorë, ku në shënimin e veçantë në kartelën e pasurisë përshkruhet se “*...kati bazë me sipërfaqe 56 m² dhe kati shtesë me sipërfaqe 56 m²*”, është e paqartë nëse apartamenti është një apo dy kate.

41. Subjekti i rivlerësimit paraqiti, gjithashtu në përgjigje të barrës së provës shkresën, nr. *** prot., datë 13.12.2018, të ZVRPP-së Vlorë sipas së cilës:

- Pasuria në *** është regjistruar në bazë të lejes së legalizimit sipas kartelës, së përcjellë në Lejen e Legalizimit.
- Pasuria është apartament 1 kat, shtesë mbi objektin 6-katësh ekzistues ku sipërfaqja e katit bazë është 56 m² (gjurma e objektit), që nënkupton sipërfaqen e banueshme dhe është e njëjta gjë.
- Shënimi, sipërfaqe kati bazë prej 56 m² dhe sipërfaqe kati shtesë 56 m² është sipërfaqja e banimit të apartamentit.
- Shënimet bëhen sipas kartelës shoqëruese të lejes së legalizimit, kartelës, planimetrisë të cilat përkojnë me njëra tjetrën.
- Kjo pasuri është kat shtesë mbi objektin 6-katësh ekzistues me sipërfaqe totale 56 m², po kaq është lëshuar edhe certifikata e pronësisë.

Arsyetimi ligjor

42. Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (ii) deklaratat periodike dorëzuar pranë ILDKPKI-së (iii)

provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, trupi gjykues arsyeton se:

43. Nga analiza në tërësi e të gjitha provave, përfshirë si provë të re përgjigjen me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2018, të ZVRPP-së Vlorë, së bashku me provat e tjera të marra gjatë hetimit administrativ nga praktika e legalizimit të apartamentit në ***, edhe me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, arrin në përfundimin se rezulton e provuar që apartamenti në *** në pronësi të bashkëshortes nuk është *dupleks*, por është apartament 1-katësh me sipërfaqe 56 m².

44. Trupi gjykues, vlerësoi të panevojshme këqyrjen e apartamentit në ***, kërkuar nga subjekti i rivlerësimit pasi vlerësoi se fakti që kërkohet të provohet rezultoi i provuar nga hetimi administrativ.

45. Likuiditete në *cash*, të akumuluar nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes në vite në shumën 1.250.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

46. I pyetur në lidhje me gjendjen *cash* subjekti i rivlerësimit deklaroi se, pjesa mbartur nga akumulimi dhe e krijuar brenda vitit të mbyllur është shpenzuar për të përballuar ndryshimin e kushteve të jetesës.

47. Balanca *cash* e reflektuar në deklaratën “Vetting”, është në atë masë për të mbajtur këtë gjendje cash në formë kursimi në vlerën e lejuar nga ligji. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë shtesë në pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, apo dhe në likuiditete bankare për ta përdorur këtë gjendje si burim krijimi të pasurive.

48. Nga analiza në tërësi e të gjitha provave, si dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit trupi gjykues vlerëson se gjendja e likuiditeteve në *cash* të deklaruar në deklaratën e pasurisë “Vetting”, më datë 30.01.2017, është në përputhshmëri me deklaratimet vjetore periodike të pasurisë, si dhe përputhet me rezultatet e hetimit administrativ.

49. Depozitat bankare të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. N. B.

50. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank” nga të ardhurat personale në vite. Shuma 4.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

51. Depozitë me afat, nr. ***, në “Veneto Banka”, nga të ardhurat personale në vite. Shuma 400.022 lekë. Pjesa takues: 100 %.

Nga hetimi administrative rezultoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. N. B, ka pasur mundësi për krijimin e këtyre depozitave

52. Pasuri e paluajtshme në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. N. B. Ajo deklaron se është bashkëpronare për shkak të ligjit, në 1/4 pjesë në pasurinë e paluajtshme, banesa e prindërve. Burimi i krijimit: Ligji mbi privatizimin e ish-banesave shtetërore.

53. Në deklarin periodik të vitit 2016 është deklaruar – *“Formalisht bashkëpronare për shkak të ligjit, në 1/4 pjesë në pasurinë e paluajtshme banesa e prindërve të mi, ndonëse qysh prej martesës në vitin 2000 nuk kam asnjë lidhje faktike, posedimi apo pronësie, mbi këtë pasuri”*. Burimi i krijimit – ligji mbi privatizimin e banesave shtetërore.

54. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

55. ZVRPP-ja Vlorë me shkresën, nr. *** prot., datë 28.02.2018, informon se në emër të shtetases N. B, rezulton pasuri në bashkëpronësi, B 1/4, në ZK ***, nr. pasurisë ***, vol. ***, fq. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 60.5 m².

56. Pasuria e paluajtshme në fshatin “****” – ***, Sarandë, 1/16 pjesë, e regjistruar në ZVRPP- në Sarandë, nga trashëgimia ligjore e babait J. Gj në bazë të vendimit nr. ***, datë 25.02.1997, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave – Sarandë. Përputhen deklarami i subjektit të rivlerësimit me provat nga hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri.

57. Automjet tip “Volkswagen – Golf”, viti i prodhimit 2004, me targa ***, blerë nga të ardhurat personale në vite në shumën 500.000 lekë, me kontratën noteriale, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016, regjistruar pranë DRSHTRr-së Vlorë. Pjesa takuese: 100 %.

58. Deklarimet ndër vite: Viti 2016 – Shtesë pasurie, automjet tip “Volkswagen – Golf”, viti i prodhimit 2004, me targa ***, blerë nga të ardhurat personale në vite, me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016, regjistruar pranë DRSHTRr-së Vlorë. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

59. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

60. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. *** prot., datë 02.05.2018, informon se znj. N. A. B, aktualisht ka automjetin me targë ***, ndërsa ka pasur më parë automjetin me targë ***.

61. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën kthim përgjigje, nr. ***prot., datë 01.08.2018, vë në dispozicion të Komisionit dosjet e automjeteve me targat *** dhe ***.

62. Automjeti me targë ***, autoveturë, tip “Volkswagen” është fituar nga znj. N. B me kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016. Sipas kësaj kontrate, znj. N. B, në cilësinë e blerëses blen nga shitësja M. M. Gj, autoveturën “Volkswagen” në shumën 500.000 lekë, dhe ky çmim i është paguar asaj me dy këste në shumat 360.000 lekë dhe 140.000 lekë.

63. Automjeti me targë ***, autoveturë, tip “Volkswagen - Golf”, ka qenë në pronësi të znj. N. B, deri më datë 02.11.2017, datë në të cilën me kontratë shitblerje automjeti, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 02.11.2017, automjeti është shitur tek blerësi V. K kundrejt shumës 3.250 euro, paguar jashtë zyrës noteriale.

64. Nga dosja e automjetit me targa ***, referuar kartelës së tij rezulton se ai është i llojit autoveturë i markës “Daimler Crysler Mercedes”, ngjyrë gri dhe është në emër të znj. N. B dhe z. Altin Binaj.

65. Përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për pasuritë e personit të lidhur me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ.

V. ANALIZA FINANCIARE

66. Gjatë hetimit administrativ është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore.

67. Nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, referuar të dhënave të mbledhura nga hetimi administrativ si dhe deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorë, ka rezultuar që subjekti të ketë pasur likuiditete të pajustificuara, për vitet 2008, 2011, 2013.

68. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera e për të provuar të kundërtën lidhur me vitet 2008, 2011, 2013.

69. Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në vitin 2008 për krijimin e pasurisë në likuiditete prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) eurosh për prenotimin e zyrës së avokatisë për bashkëshorten, si dhe për përballimin e shpenzimeve të kryera në atë vit, me burime të ligjshme të ardhurash.

70. Barra e provës i është dërguar subjektit për këtë vit financiar në baze të të dhënave të autoritetit tatimor në përputhje me legjislacionin tatimor deri në vitin 2010, në Republikën e Shqipërisë.

71. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës për pamjaftueshmëri financiare për vitin 2008 shpjegoi si më poshtë vijon:

72. Me shkresën e datës 21.12.2018 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, dhe me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2018, saktësohen të ardhurat e bashkëshortes për vitin 2008. Ato janë të ndryshme nga informacioni i dërguar nga këto organe pranë Komisionit. Kjo shkresë u paraqit së bashku me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore të parashikuara nga legjislacioni fiskal shqiptar.

73. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit paraqiti pranë Komisionit provën e re shkresore, nr. *** prot., datë 27.12.201, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë.

74. Subjekti i rivlerësimit depozitoi konfirmimin me shkresën e organit kompetent në atë vit, Bashkisë Vlorë, për të ardhura të deklaruara nën vlerën 2.000.000 lekë, në vitin 2008, sipas së cilës bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka shlyer të gjitha detyrimet sipas legjislacionit fiskal shqiptar.

75. Lidhur me të ardhurat e ligjshme të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, trupi gjyqës, vendosi të pranojë dhe të marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja në vite sipas shkresave të datës 21.12.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë si dhe shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2018.

76. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ dhe pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, trupi gjyqës, arrin në përfundimin se analiza financiare për vitin 2008 për subjektin e rivlerësimit, ndryshoi si vijon:

| Analiza financiare viti 2008 | Rezultate Hetimi | Analiza përfundimtare |
|---|---------------------|--------------------------|
| Të ardhurat neto nga pagat e subjektit | 1.559.003 | 1.559.003 |
| Të ardhura në “Union Bank” llogari e subjektit, honorarë | 431.280 | 431.280 |
| Të ardhura të bashkëshortes Avokatia | 612.000 | 1.376.284 |
| Të ardhura bashkëshortes Refleksione | 240.829 | 240.829 |
| Të ardhura nga pensioni | 191.682 | 191.682 |
| Të ardhura të tjera | 12.307 | 12.307 |

| | | |
|--|------------------|------------------|
| Total të ardhura (1) | 3.047.101 | 3.811.385 |
| Shpenzime arredimi të shpërndara | 0 | 83.333 |
| Pagesë shpenzime jetese | 800.000 | 800.000 |
| Shpenzime total (2) | 800.000 | 883.333 |
| Ndryshim mj. mon. cash gj. fillim - gj. fund periudhe | 0 | 0 |
| Ndryshim mj. mon, banke gj. fillim - gj. fund periudhe | -1.088.959 | -1.088.959 |
| Mjete monetare të disponueshme (3) | 1.158.142 | 1.839.093 |
| Pagesa për blerje pasurie | 1.857.000 | 1.857.000 |
| Detyrime | 0 | 0 |
| Pasuri neto (4) | 1.857.000 | 1.857.000 |
| Balanca e fondeve (3-4) | -698.858 | -17.907 |

77. Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 2008 në shumën prej -17.907 lekësh, nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare, është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe duke çmuar se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

78. Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare të familjes për të justifikuar të ardhurat monetare shtesë, si dhe shpenzimet për shkollimin, pushime dhe jetesë për vitin 2011.

79. Nga dokumentacioni dhe provat që Komisioni disponon si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë pyetësorëve, mjetet monetare të disponueshme për këtë vit kalendarik ishin në vlerën prej 683.262 lekësh duke sjellë si rezultat edhe balancën e fondeve negative për këtë vit në vlerën prej -1.816.738 lekësh. Gjithashtu në këtë analizë financiare Komisioni nuk kishte llogaritur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga bashkëpunimi me “IFC”, për arsye të mungesës së dokumentacionit të plotë provues ligjor për këtë pagesë.

80. Pas kalimit të barrës së provës subjekti shpjegoi se për krijimin e mjeteve monetare të disponueshme për këtë vit financiar i ka shërbyer tërheqja e likuiditeteve nga llogaria e pagës, më datë 16.12.2010, për nevoja familjare në vitin pasardhës, 2011, likuiditetet, duke pretenduar

se likuiditetet e tërhequra deri 14 ditë para fundit të vitit 2010, janë mbartur në vitin 2011 bazuar në sa më poshtë:

- Pas tërheqjes së tyre nuk ka asnjë shtim të ndonjë lloj pasurie, të luajtshme ose të pa luajtshme;
- Pas tërheqjes së tyre nuk ka asnjë shpenzim të kryer, sikurse dalje jashtë shtetit apo të tjera;
- Edhe bashkëshortja nuk ka pasur shpenzime shtesë në muajin dhjetor 2010.

81. Gjithashtu për të ardhurat nga “IFC” dhe ato me “Emporiki Bank”, subjekti i rivlerësimit, solli shpjegime dhe prova për të provuar raportin e bashkëpunimit dhe të ardhurat e fituara nga këto dy bashkëpunime nëpërmjet shumave të depozituara në bankë, dhe për të cilat janë shlyer detyrimet fiskale.

82. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ dhe pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, trupi gjykues, arrin në përfundimin se analiza financiare për vitin 2011 për subjektin e rivlerësimit, ndryshoi si vijon:

| Analiza financiare viti 2011 | Rezultate Hetimi | Analiza përfundimtare |
|--|---------------------|--------------------------|
| Të ardhurat neto nga pagat e subjektit | 1.451.934 | 1.451.934 |
| Të ardhura të bashkëshortes Avokatia | 320.000 | 320.000 |
| Të ardhura të bashkëshortes “IFC” | 0 | 825.000 |
| Të ardhura nga pensioni | 228.864 | 228.864 |
| Të ardhura të tjera | 6.883 | 6.883 |
| Total të ardhura (1) | 2.007.681 | 2.832.681 |
| Pagesë shkollimi | 179.220 | 179.220 |
| Pagesë pushime, Itali, 1.400 euro | 194.502 | 194.502 |
| Shpenzime arredimi të shpërndara | 0 | 0 |
| Pagesë shpenzime jetese | 800.000 | 583.440 |
| Shpenzime total (2) | 1.173.722 | 957.162 |
| Ndryshim mjete monetare gj. fillim-gj. fund periudhe | -150.697 | -150.598 |
| Mjete monetare të disponueshme (3) | 683.262 | 1.724.921 |
| Ndryshim pasurie gjendje <i>cash</i> | 2.500.000 | 1.255.695 |
| Detyrime | 0 | 0 |

| | | |
|-------------------|------------|-----------|
| Pasuri neto | 2.500.000 | 1.255.695 |
| Balanca e fondeve | -1.816.738 | 469.226 |

83. Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare të familjes për të justifikuar të ardhurat monetare shtesë, si dhe shpenzimet për shkollimin, pushime dhe jetesë për vitin 2013.

84. Nisur nga dokumentacioni ligjor referues si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerat monetare *cash*, shpenzimet e arredimit të banesës si dhe shpenzime të tjera të deklaruara, rezulton se për vitin e mbyllur 2013, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni familja Binaj duket se ka një pamjaftueshmëri financiare për krijimin e pasurisë dhe shpenzimeve të deklaruara.

85. Për sa më sipër ju kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati hetimi.

86. Në përgjigje të barrës së provës subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ai nuk ka deklaruar asnjëherë, as në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit dhe as në deklaratën e pasurisë për vitin 2013, se ajo pasuri e paluajtshme është krijuar vetëm nga të ardhura të vitit të mbyllur 2013.

87. Përkundrazi, në deklaratën e interesave periodik/vjetor të pasurisë për vitin 2013, kur kjo pasuri është krijuar dhe është deklaruar rregullisht sipas ligjit, lidhur me përkrahimin e pasurisë dhe burimin e krijimit të saj ka deklaruar shprehimisht dhe pa asnjë ekuivok si vijon : “*Burimi i krijimit të pasurisë: Nga të ardhurat personale dhe familjare të grumbulluara në vite*”, deklarim i cili gjendet në faqen 9 të “Deklaratës të Pasurive për vitin 2013”.

88. Apartamenti në Orikum, si pasuri e paluajtshme, është krijuar jo vetëm nga të ardhurat e grumbulluara nga familja gjatë vitit 2013, por edhe ato të akumuluar nga vitet e mëparshme.

89. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se shpenzimet për arredimin e apartamentit në Orikum në shumën fikse prej 600.000 lekësh nuk janë vetëm për vitin **2013**. Nëse do kishte ndodhur kjo, një vlerë shpenzimi të tillë do ta pasqyronte në deklaratimet respektivë të pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, me ndryshimet përkatëse.

90. Për apartamentin në Orikum, shpenzimet e arredimit kanë qenë në shumën fikse prej 600.000 lekësh, vlera e përgjithshme e orendive dhe pajisjeve, të shpenzuara nga të ardhurat e ligjshme të familjes duke filluar nga viti 2013, ndaj shuma prej 600.000 (gjashtëqind mijë) lekësh, nuk duhet të llogaritet vetëm për vitin 2013.

91. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ dhe pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, trupi gjykues arrin në përfundimin se analiza financiare për vitin 2013 për subjektin e rivlerësimit, ndryshoi si vijon:

| Analiza financiare 2013 | Rezultate Hetimi | Analiza përfundimtare |
|---|---------------------|--------------------------|
| Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblime të subjektit | 1.525.012 | 1.525.012 |
| Të ardhura të bashkëshortes, Avokatia | 390.454 | 390.454 |
| Të ardhura nga pensioni | 246.256 | 246.256 |
| Total të ardhura (1) | 2.161.722 | 2.161.722 |
| Pagesë kredi | 178.105 | 178.105 |
| Pagesë shkolle | 154.231 | 154.231 |
| Shpenzime shëndetësore | 121.347 | 121.347 |
| Shpenzime të tjera | 20.445 | 20.445 |
| Shpenzime për arredim shpërndarë | 600.000 | 203.333 |
| Pagesë shpenzime jetese | 800.000 | 800.000 |
| Shpenzime total (2) | 1.874.128 | 1.477.461 |
| Ndryshim mjete monetare cash gj. fillim-gj. fund periudhe | 1.100.000 | 1.100.000 |
| Ndryshim mjete monetare gj. fillim-gj. fund periudhe | 283.700 | 283.700 |
| Mjete monetare të disponueshme (3) | 1.671.294 | 2.067.961 |
| Pagesa për blerje pasurie, 15.000 euro | | |
| Orikum | 2.103.150 | 2.103.150 |
| Detyrime | 0 | 0 |
| Pasuri neto | 2.103.150 | 2.103.150 |
| Balanca e fondeve | -431.856 | -35.189 |

92. Trupi gjykues, vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 2013, në shumën prej -35.189 lekësh, nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare, është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar e duke çmuar se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzioni për komponentin e vlerësimit të pasurisë.

93. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Binaj, trupi gjykues vlerëson se ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

Trupi gjykues vlerëson se diferencat e konstatuara në analizën financiare të vitit 2008 e 2013 nuk janë në masën që cenojnë besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare, është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë mase¹, nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka treguar një qasje korrekte e të sinqertë në raport me deklarin e tij në deklaratën e pasurisë “Vetting”, por në mënyrë të vazhdueshme edhe në deklaratat e pasurisë në vite, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ai nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka bërë deklarin të mjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

VI. VLERËSIMI I FIGURËS

94. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/206, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Altin Binaj.

95. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarin për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

96. Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹ Vendimi nr. 70, datë 16.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Konkluzioni për kontrollin e figurës

97. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, dhe është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

VII. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

98. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm.

99. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

1. Formularin e vetëdeklarimit si dhe të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
2. Pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor;
3. Të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të administruara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

100. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

101. Raporti është përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

102. Anëtarët e Grupit të Punës, prokurorët në Prokurorinë e Përgjithshme, z. A. Xh dhe z. S. S, të caktuar me Urdhërin nr. ***, datë 17.10.2017, “Për ngritjen e Grupit të punës për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar”, ndryshuar me Urdhërin nr. ***, datë 09.11.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe Urdhërin nr. ***, datë

09.01.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për riorganizimin e Grupit të Punës për hartimin e raportit në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar”, për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të z. Altin Binaj, prokuror/ Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, kanë hartuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Raporti është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij nga Grupi i Punës. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

103. Në lidhje me njohuritë ligjore nga analiza e tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Prokurori Altin Binaj, bën një analizë të qartë të dispozitave ligjore duke u ndalur në zbatimin e saj referuar të dhënave të rastit objekt gjykimi. Shfaq njohuri të mira dhe të plota në drejtim të normave të Kodit të Procedurës Penale (shiko gjetjet në dosjen nr. 2, 3, 4, 5), njohuri të mira në drejtim të metodikave të hetimit (shiko gjetjet në dosjen nr. 1, 4).

104. Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit mbi kualifikimet në fushën e të drejtës penale, konstatohet se ka marrë pjesë në cilësinë e ekspertit në Shkollën e Magjistraturës në dy tema në fushën penale, gjë që tregon për aftësi të mira në njohjen e ligjit.

105. Në lidhje me arsyetimin ligjor, nga analiza e tre dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e përgatitura prej tij, paraqiten të strukturuar në mënyrë logjike dhe me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimorë dhe etike. Teksti është i ndarë në paragrafë, fjalitë janë të qarta dhe vendosen referencat ligjore përkatëse penale, procedurale e kushtetuese, duke e bërë të saktë e të plotë arsyetimin mbi zgjidhjen e çështjes. Prokurori i kushton vëmendjen e duhur që në aktet ligjore që përgatit, të analizojë të gjitha çështjet që paraqiten për zgjidhje, duke ruajtur lidhjen logjike të arsyetimit ligjor dhe duke konkluduar në fund, bazuar në normën përkatëse ligjore. Gjithashtu në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit ligjor që përgatit, nga ana e subjektit të rivlerësimit, respektohen rregullat e drejtshkrimit, duke përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

106. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nga vlerësimet e bëra nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015, 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, është vlerësuar shumë mirë për aftësitë profesionale të shfaqura gjatë ushtrimit të detyrës së tij në tre vitet e fundit. Më konkretisht në këto vlerësime, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar si vijon:

107. Në lidhje me aftësitë organizative dhe aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka deklaruar se për periudhën qershor 2013 deri në korrik 2016 ka

ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ku ka qenë për një periudhë edhe në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit dhe Kontrollit të Krimit Ekonomik, Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe në vazhdim ka ushtruar dhe ushtron detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

108. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes. Nga vlerësimet e punës të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015, 2016, subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, është vlerësuar “Shumë mirë”, për aftësitë administruese/drejtuese. Në këto vlerësime pune, për subjektin e rivlerësimit evidentohet se:

109. Subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka përballuar një volum të lartë dhe kompleks në punë, me cilësi dhe shpejtësi. Është dalluar për planifikimin e mirë të punës dhe detyrave, si dhe marrjen pjesë edhe personalisht në kryerjen e tyre. Ka treguar aftësi të larta drejtuese e kontrolluese, duke bërë një organizim shumë të mirë të punës në prokurori, duke e rregulluar organizimin dhe mirëfunksionimin e punës së çdo strukture nëpërmjet urdhrave të detajuar, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm ecurinë efektive të hetimeve dhe punën e secilit prokuror. Ka shfaqur aftësi të veçanta dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë që drejton, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

Ka bashkëpunuar frytshëm me të gjitha institucionet shtetërore, duke mbajtur një komunikim korrekt, në përputhje me normat ligjore dhe morale, me publikun dhe me persona të tretë.

110. Në lidhje me aftësinë për të kryer procedurat hetimore/ gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, prokurori Altin Binaj, në cilësinë e prokurorit, drejtorit në Prokurorinë e Përgjithshme ka vendosur për kallëzime të regjistruara, ka marrë pjesë në gjykim duke përfaqësuar Prokurorinë e Përgjithshme në Gjykatën e Lartë dhe gjithashtu në cilësinë e prokurorit të apelit merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar prokurorinë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

111. Nga analiza e dokumenteve ligjor evidentohet se subjekti i rivlerësimit është i aftë profesionalisht në këto pjesëmarrje dhe për qëndrimin që mban për çështjet.

112. Në lidhje me aftësinë për të administruar dosjet, nga dosjet e vëzhguara, vërehet se ato janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

113. Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, nga aktet e përzgjedhura, nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

114. Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas shkresës me nr. 383/14 prot., datë 22.02.2018, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Altin Binaj, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

115. Në lidhje me integritetin, nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

116. Në lidhje me paanësinë nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Altin Binaj. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

117. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Altin Binaj, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

118. Në lidhje me aftësitë e komunikimit nga tre dokumentet ligjore të vetë përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Nga vlerësimet e punës për periudhën 2014, 2015, 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, prokurori Altin Binaj, ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

119. Në lidhje me aftësinë për të bashkëpunuar, në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Altin Binaj, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

120. Lidhur me këtë aftësi, nga vlerësimet e punës së bërë për vitet 2014, 2015 e 2016 nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Binaj, në cilësinë e prokurorit, Drejtorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Drejtuesit të Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, është evidentuar fakti i aftësisë për të ndarë përvojën me kolegët; i aftësisë për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie korrekte me të gjitha palët dhe për të mbajtur marrëdhënie institucionale e korrekte me të gjitha institucionet ligjzbatuese me të cilat ka ndërvepruar.

121. Në lidhje me gatishmërinë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit, prokurori Altin Binaj, rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitete

profesionale të organizuara, qoftë në rolin e pjesëmarrësit, qoftë si lektor. Konkretisht në këtë periudhë rezulton të ketë marrë pjesë në këto aktivitete profesionale si dhe ka qenë lektor në Shkollën e Magjistraturës.

122. Pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, si më sipër, Komisioni, nuk gjeti asnjë indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Konkluzione për komponentin e vlerësimit profesional

123. Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të vlerësimit, sipas pikës a) trupi gjykues bazuar në (i) konstatimet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se:

124. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

VIII. DENONCIME

125. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në lidhje me subjektin e rivlerësimit janë depozituar 2 denoncime.

1. Denoncim nga shtetasi G. T.

Sipas raportit të aftësive profesionale, në lidhje me ankesën e paraqitur nga shtetasi G. T, lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Altin Binaj, konstatohet se:

Nuk ka të dhëna konkrete se përse subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, është i përfshirë sipas kallëzuesit, në veprimtarinë kriminale që kallëzuesi pretendon. Kallëzuesi rezulton se është i përfshirë në procese gjyqësore që në vitin 2008, ku rezulton se ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, kohë në të cilën ka qenë si Drejtues i Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit.

2. Denoncim nga shtetasi A. Rr.

Ky kallëzim i drejtohet një grupi prej 19 subjektsh rivlerësimi, midis të cilëve edhe për subjektin e rivlerësimit, z. Altin Binaj, për të cilët kërkon të ndiqen penalisht:

“Altin Binaj, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, në kohën kur policia dhe prokuroria vepronin në mënyrë të jashtëligjshme. Sidomos kur prokurori Ç. S, me një vendim

*të mbushur qëllimisht me gënjeshtër, më dhunoi në shtëpinë time. Tjetër provë është, kërkesa ime për ndjekje penale për Kryetarin e Bashkisë z. B. Z dhe znj. V. M, për falsifikimin e dokumentit se unë gjoja kam qenë i pastrehë deri në vitin 1995, ku është tentuar për tjetërsimin e pronësisë së shtëpisë. Altin Binaj, nuk pranoi të hapte çështje penale, ndonëse i dërgova një kopje të dokumentit. Përgjigja e A. B është abuzim me detyrën, duke fshehur krimin. Përgjigja nr. ***, datë 05.11.2009, firmosur Altin Binaj”.*

126. Pas shqyrtimit të dy denoncimeve të paraqitura në raport me elementët e nenit 53 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se “1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim. 2. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit”. Nga Komisioni nuk u gjetën indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, për veprime apo elementë që cenojnë figurën e prokurorit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Altin Binaj, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Altin Binaj.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim shpall në Tiranë, më datë 23.01.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)

Kryesuese

Pamela QIRKO

Anëtare

Xhensila PINE

Relatore

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka